



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1397/ 6 prot.

Datë 22.07.2024

V E N D I M
Nr. 934/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 22.07.2024 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

“Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “GAMMA” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me objekt “LOTI II: “Blerje pajisje didaktike për kimi, arsimit bazë dhe i mesëm” me Nr. REF-06447-05-24-2024, me fond limit: 32,009,816.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 26-06-2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me objekt “LOTI II: “Blerje pajisje didaktike për kimi, arsimit bazë dhe i mesëm” me Nr. REF-06447-05-24-2024 me fond limit: 32,009,816.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 26-06-2024, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

- Ankimues:** Operatori ekonomik “GAMMA” SHPK me NIPT K31510153H adresë: Njësia Administrative nr.8, Rruga “Dervish Hekali”, Ndërtesa nr. 8.
- Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Blerjeve të Përqendruara me adresë; Blv.“Dëshmorët e Kombit”, nr. 3, Tiranë
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesat e paraqitura nga operatorët ekonomikë ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

- I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është mbi kufirin e larte monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.
- I.2. Operatori ekonomikë ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.
- I.3. Operatori ekonomikë ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”.
- I.4. Operatori ekonomik ankimues, ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 27-05-2024, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “*E hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me objekt “LOTI II: “Blerje pajisje didaktike për kimi, arsimit bazë dhe i mesëm” me Nr. REF-06447-05-24-2024, me fond limit: 32,009,816.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 26-06-2024, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 02.03.2024, është paraqitur nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike ankesa e operatorit ekonomik “GAMMA” SHPK, me numër ankimi elektronik A/2024/4145, protokolluar me nr. 1397/2024 prot., datë 03.06.2024, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi.

II.2.1. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.2.2 Ne datën 05.06.2024, Autoriteti Kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara, dërgon shkresën me Nr. 274/10 me objekt “Vënie në dijeni mbi zgjatjen e afatit për shqyrtimin e ankesës”, protokolluar me tonën nr. 1397/2, datë 07.06.2024.

II.2.2 Me anë të shkresës nr. 274/20 prot., datë 01.07.2024, protokolluar me tonën me nr. 1397/3 prot., datë 03.07.2024, me objekt “*Dërgim Vendimi*”, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik Vendimin Nr. 274/16, datë 28.06.2024, ku konstatohet, se e ka pranuar pjesërisht atë, si më poshtë:

*“[...]** KSHA konstaton se ne plotesimin e DT dhe procesverbalit të argumentimit ishte bere nje lapsus nga AK. Per kite arsye si dhe ne mbështetje te Ligjit 162/2021 "Per prokurimin publik" s ndryshuar, Neni 2 "Qellimi i ligjit" , me qellim ritjen e nxitjes se pjesemarrjes se operatoreve ekonomike ne kete procedure prokurimi, nxitjen e konkurrences ndërmjet operatoreve ekonomike per kete procedure prokurimi, sigurimin e nje trajtimi te barabarte dhe jodiskriminues per te githe operatoret ekonomike pjesemarrres, bëhen ndryshimet ne piken 2.2.1 te kriterëve te veçanta te percaktuara ne DT si me poshte: Ishte: 2.2.1. Per te provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatoret ekonomike duhet te paraqesin deklaratat per xhiron vietore per vitet financiare 2021, 2022, 2023, dhe vlera e xhiros per te pakten nje nga vitet e periudhes se kerkuar duhet te jete jo më e vogël se 40% e vleres se perlllogaritur te lotit ose grupeve te loteve ne rast se ofertuesi i suksesshem merr disa lote qe duhen te zbatohen ne te njëjtën kohe. Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit ne raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes se tyre ne bashkim. Behet: 2.2.1. Per te provuar kapacitetet financiare dhe*

ekonomike, operatorit ekonomike duhet te paraqesin deklaratat per xhiron vjetore per vitet financiare 2021, 2022, 2023, dhe vlera e xhiros per te pakten një nga vitet e periudhes se kerkuar duhet te jete jo me e vogël se 39% e vleres se perlllogaritur te lotit ose grupeve te loteve ne rast se ofertuesi i suksesshem merr disa lote që duhet te zbatohen ne te njejtën kohe. Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomike ky kriter plotesohet nga secili anëtar i bashkimit ne raport me perqindjen dhe/ose kushtet e pjesemarrjes se tyre ne bashkim.

Per sa me siper, pretendimet e OE qendrojne.

*** KSHA konstaton se ne plotesimin e DT dhe procesverbalit te argumentimit shte bere nje lapsus nga AK. Për kete arsye si dhe ne mbeshtetje te Ligjit 162/2021 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, Neni 2 "Qëllimi i ligjit" , me qellim rritjen e nxitjes se pjesemarrjes se operatoreve ekonomike ne kete procedure prokurimi, nxitjen e konkurrences ndermjet operatoreve ekonomike per kete procedure prokurimi, sigurimin e nje trajtimi te barabarte dhe jodiskriminues per te giithe operatoret ekonomike pjesemarres, behen ndryshimet ne piken 2.3.1 te kritereve te vecanta te percaktuara ne DT si më poshte: Ishte: 2.3.1. Operatori ekonomik duhet te paraqese deshmi per realizimin me sukses të nje ose disa kontratave te meparshme të ngjashme, te kryera giatë tre viteve te fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates, ne nje vlere jo me te vogel se 39% te vlerës se perlllogaritur te lotit apo grupeve te loteve ne rast se ofertuesi i suksesshem merr disa lote ge duhet te zbatohen ne te njejtën kohe.*

Per te vertetuar pervojen e meparshme te ngjashme, operatoret ekonomike duhet te paraqesin deshmitet e meposhime: - per pervojen e meparshme te realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vertetime te leshuara nga nje ent publik per permbushjen me sukses të kontrates, ku të shenohen vlera, afati i perfundimit te kontrates ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fugi, ku shenohen datat, shumat dhe sasite e mallrave te furnizuara, - per pervojen e meparshme te realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqese fatura tatimore të shitjes, te plotësuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fugi, dhe te deklaruar ne organet tatimore, ku shenohen datat, shumat dhe sasite e mallrave të furnizuara. Behet: 2.3.1. Operatori ekonomik duhet te paraqesë deshmi per realizimin me sukses te nje ose disa kontratave të meparshme te ngjashme, te kryera giate tre viteve le fundit nga data e shpalljes së njoftimit te kontrates, ne nje viere jo me lë vogël se 19% te vlerës se perlllogaritur te lotit apo truer le loteve ne rast se afertuest i sukseshem merr disa lote ge duher te zbatohen ne te ëieten deshmitet e mëposhtme: Per te vertetuar pervojen e mëparshme te ngjashme, operatoret ekonomike duhet të paraqesin - per pervojen e meparshme te realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet te paraqesë vertetime te leshuara nga nje ent publik per permbushjen me sukses te kontrates, ku te shenohen vlera, afati i perfundimit te kontrates ose/dhe fatura tatimore te shitjes, te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit në fugi, ku shënohen datat, shumat dhe sasite e mallrave te furnizuara, - per pervojën e meparshme te realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet te paraqese fatura tatimore te shitjes, te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fugi, dhe te deklaruar ne organet tatimore, ku shenohen datat, shumat dhe sasite e mallrave te turnzuara. Per sa me siper, pretendime e OE qendrojne.

*** Lidhur me pretendimin e pikes se tete objekt ankimi : Referuar kesaj pike, per pretendimet e operatorit ekonomik ne lidhje me specifikimet teknike të mallrave objekt prokurimi, KSHA me anë te shkresës nr. 274/9 prot., date 05.06.2024 "Kërkesë per informacion" i ka kerkuar Autoritetit Kontraktor "Ministria e Arsimit dhe Sportit" ne cilësinë e hartuesit te specifikimeve teknike per artikujt objekt ankese, rishikimin e tyre, duke mbajtur në vemendje parimet e LPP si dhe aktet nënligjore ne zbatim te tij. Me shkresën me lëndë "Kthim pergjigje" protokolluar me tonën me nr. 274/15 prot., date 27.06.2024 Autoritetit Kontraktor "Ministria e Arsimit dhe Sportit" ka kthyer pergjigje duke reflektuar ndryshimet perkatese ne specifikimet teknike. Ne këto kushte ngarkohet njesia e prokurimit qe me anë te nje shtojce te ngarkoje në SPE ndryshimet e siperpermendura, bashkelidhur ketij vendimi. Per sa me siper, pretendimi i OE qendron ."*

III

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur tij si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

II.1. Lidhur me pretendimet e ankimuesve për modifikimin e dokumenteve të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Me anë të shkresës nr. 274/20 prot., datë 01.07.2024 protokolluar me tonën me nr. 1397/3 prot., datë 03.07.2024, me objekt "Dërgim - Vendimi", autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik Vendimin Nr. 274/16, datë 28.06.2024, ku konstatohet, se e ka pranuar pjesërisht atë, si më poshtë:

*"[...]** KSHA konstaton se ne plotesimin e DT dhe procesverbalit te argumentimit ishte bere nje lapsus nga AK. Per kite arsye si dhe ne mbështetje te Ligjit 162/2021 "Per prokurimin publik" s ndryshuar, Neni 2 "Qellimi i ligjit" , me qellim ritjen e nxitjes se pjesemarrjes se operatoreve ekonomike ne kete procedure prokurimi, nxitjen e konkurrences ndërmjet operatoreve ekonomike per kete procedure prokurimi, sigurimin e nje trajtimi te barabarte dhe jodiskriminues per te githe operatoret ekonomike pjesemarrës, bëhen ndryshimet ne piken 2.2.1 te kriterëve te veçanta te percaktuara ne DT si me poshte: Ishte: 2.2.1. Per te provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatoret ekonomike duhet te paraqesin deklaratat per xhiron vietore per vitet financiare 2021, 2022, 2023, dhe vlera e xhiros per te pakten nje nga vitet e periudhes se kerkuar duhet te jete jo më e vogël se 40% e vleres se perlllogaritur te lotit ose grupeve te loteve ne rast se ofertuesi i suksesshem merr disa lote qe duhen te zbatohen ne te njëjtën kohe. Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit ne raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes se tyre ne bashkim. Behet: 2.2.1. Per te provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorit ekonomike duhet te paraqesin deklaratat per xhiron vjetore per vitet financiare 2021, 2022, 2023, dhe vlera e xhiros per te pakten një nga vitet e periudhes se kerkuar duhet te jete jo me e vogël se 39% e vleres se perlllogaritur te lotit ose grupeve te loteve ne rast se ofertuesi i suksesshem merr disa lote që duhet te zbatohen ne te njëjtën kohe.*

Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomike ky kriter plotesohet nga secili anëtar i bashkimit ne raport me perqindjen dhe/ose kushtet e pjesemarrjes se tyre ne bashkim.

Per sa me siper, pretendimet e OE qendrojne.

*** KSHA konstaton se ne plotesimin e DT dhe procesverbalit te argumentimit shte bere nje lapsus nga AK. Për kete arsye si dhe ne mbeshetje te Ligjit 162/2021 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, Neni 2 "Qëllimi i ligjit" ', me qellim rritjen e nxitjes se pjesemarrjes se operatoreve ekonomike ne kete procedure prokurimi, nxitjen e konkurrences ndermjet operatoreve ekonomike per kete procedure prokurimi, sigurimin e nje trajtimi te barabarte dhe jodiskriminues per te giithe operatoret ekonomike pjesemarres, behen ndryshimet ne piken 2.3.1 te kritereve te vecanta te percaktuara ne DT si më poshte: Ishte: 2.3.1. Operatori ekonomik duhet te paraqese deshmi per realizimin me sukses të nje ose disa kontratave te meparshme të ngjashme, te kryera giatë tre viteve te fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates, ne nje vlere jo me te vogel se 39% te vlerës se perlllogaritur te lotit apo grupeve te loteve ne rast se ofertuesi i suksesshem merr disa lote ge duhet te zbatohen ne te njejtën kohe.*

Per te vertetuar pervojen e meparshme te ngjashme, operatoret ekonomike duhet te paraqesin deshmitë e meposhime: - per pervojen e meparshme te realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vertetime te leshuara nga nje ent publik per permbushjen me sukses të kontrates, ku të shenohen vlera, afati i perfundimit te kontrates ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fugi, ku shenohen datat, shumat dhe sasite e mallrave te furnizuara, - per pervojen e meparshme te realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paragese fatura tatimore të shitjes, te plotësuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fugi, dhe te deklaruar ne organet tatimore, ku shenohen datat, shumat dhe sasite e mallrave të furnizuara. Behet: 2.3.1. Operatori ekonomik dunet te paraqesë deshmi per realizimin me sukses te nje ose disa kontratave të meparshme te ngjashme, te kryera giate tre viteve le fundit nga data e shpalljes së njoftimit te kontrates, ne nje viere jo me lë vogël se 19% te vlerës se perlllogaritur te lotit apo truer le loteve ne rast se afertuest i sukseshem merr disa lote ge duher te zbatohen ne te ëieten deshmitë e mëposhtme: Per te vertetuar pervojen e mëparshme te ngiashme, operatoret ekonomike duhet lë paragesin - per pervojen e meparshme te realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet te paraqesë vertetime te leshuara nga nje ent publik per permbushjen me sukses te kontrates, ku te shenohen vlera, afati i perfundimit te kontrates ose/dhe fatura tatimore te shitjes, te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit në fugi, ku shënohen datat, shumat dhe sasite e mallrave te furnizuara, - per pervojën e meparshme te realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet te paragese fatura tatimore te shitjes, te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fugi, dhe te deklaruar ne organet tatimore, ku shenohen datat, shumat dhe sasite e mallrave te turnzuara. Per sa me siper, pretendime e OE qendrojne.

*** Lidhur me pretendimin e pikes se tete objekt ankimi : Referuar kesaj pike, per pretendimet e operatorit ekonomik ne lidhje me specifikimet teknike të mallrave objekt prokurimi, KSHA me anë te shkresës nr. 274/9 prot., date 05.06.2024 "Kërkesë per informacion" i ka kerkuar*

Autoritetit Kontraktor "Ministria e Arsimit dhe Sportit" ne cilësinë e hartuesit te specifikimeve teknike per artikujt objekt ankese, rishikimin e tyre, duke mbajtur në vëmendje parimet e LPP si dhe aktet nënligjore ne zbatim te tij. Me shkresën me lëndë "Kthim pergjigje" protokolluar me tonën me nr. 274/15 prot., date 27.06.2024 Autoritetit Kontraktor "Ministria e Arsimit dhe Sportit" ka kthyer pergjigje duke reflektuar ndryshimet perkatese ne specifikimet teknike. Ne këto kushte ngarkohet njesia e prokurimit qe me anë te nje shtojce te ngarkoje në SPE ndryshimet e siperpermendura, bashkelidhur ketij vendimi. Per sa me siper, pretendimi i OE qendron ."

III.1.2. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.*

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i cili parashikon shprehimisht se : *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.

Për këtë arsye, KPP do të mbyllë shqyrtimin e çështjes në lidhje me këto pjesë të pranuar nga autoriteti kontraktor, për ankesën me nr. 1397 prot, datë 03.06.2024, të operatorit ekonomik "GAMMA" SHPK. Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje publikimin e shtojcës sipas pranimin të KSHA-së lidhur me pretendimet e mësipërme.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Gamma” SHPK ku kërkon: Në Njoftimin e kontratës është parashikuar: 2.11 kohëzgjatja e kontratës ose afati i zbatimit të kontratës: 12 muaj 2.11.1. Kohëzgjatja e marrëveshjes kuadër: 12 muaj (dymbëdhjetë) kohëzgjatja në muaj: 12 muaj (dymbëdhjetë) ndërsa në shtojcën 6 termat e referencës dhe grafiku i lëvrimit është përcaktuar: Sasia e mallit që kërkohet: Afatet e lëvrimit: 90 ditë është detyrë e njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit ti hartojnë ato në mënyrë të plotë dhe të saktë. Kërkojmë sqarime në lidhje me afatin e saktë të kohëzgjatjes së kontratës.

Tek Shtojca njoftimi i kontratës është përcaktuar: 4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: A) Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto ? Sipas rëndësisë: Çmimi ? Pikët?? _____? Autoriteti/ Enti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit. OSE B) oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në Çmim X NË rastin e marrëveshjes kuader, kur do të përdoret kriteri i vlerësimit të Çmimit për njësi, për qëllime krahasimi, vlerësimi i ofertave të paraqitura do të bëhet në bazë të shumatores së Çmimeve për njësi (Kjo, metodë vlerësimi nuk do të përdoret nga autoritetet/entet kontraktore kur sasitë janë të llogaritshme në bazë vjetore, sipas eksperiencës së mëparshme, dhe kur marrëveshja kuadër përdoret për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve të vazhdueshme. NË këtë rast, Çmimi i ulët do të vlerësohet me vlerën totale më të ulët të ofruar). Nga ana e njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit është nënvizuar se vlerësimi i ofertave të paraqitura do të bëhet në bazë të shumatores së Çmimeve për njësi ndërkohë që tek pika 2.10, e po kësaj shtojce, vlera e shumatores së Çmimeve për njësi është lënë e paplotësuar! Kërkojmë sqarime në lidhje me mënyrën e vlerësimit të ofertave: do të bëhet mbi bazën e vlerës totale të ofertës apo mbi bazën e shumatores së Çmimeve për njësi!?

III.2.1 KPP-ja gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjitha palët në proces.

III.2.2. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në rastin konkret ndodhemi para kërimit për sqarime mbi kriterin në procedurën e mësipërme të prokurimit dhe në këtë kuadër objekti i ankesës së operatorit ekonomik ankimes nuk lidhet me kundërshtimin e një vendimi të shprehur nga ana e autoritetit kontraktor (verifikimin ligjor në rast se projekti apo specifikimi teknik/ apo kriteri është në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik), por në thelb janë paqartësi mbi kërkesën e sipërpërmendur. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 75 të LPP-së, i cili parashikon shprehimisht se: “Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të 13 tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit

përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit. Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit”, në kthim - përgjigjen me nr. 274/16 prot., datë 28.06.2024, protokolluar me tonën nr. 1397/3 , datë 03.07.2024, ka sqaruar se “Ne Njoftimin e Kontratës është parashikuar: 2.11 Kohezigjatja e kontrates ose afati i zbatimit te kontrates: 12 muaj 2.11.1. Kohezigjatja e Marrëveshjes Kuadër: 12 muaj (dymbëdhjete) Kohezigjalja ne muaj: 12 muaj (dymbëdhjete) ndërsa në Shtojcën 6 termat e references dhe grafiku i levrimit është percaktuar: Sasia e mallit qe kerkohet: Afatet e levrimit: 90 dite është detyre e njesise se hartimit te dokumenteve te tenderit ti hartojne ato ne menyre te plote dhe te sakte. Kerkojme sqarime ne lidhje me afatin e sakte te kohezigjatjes se kontrates. Ne njoftimin e kontrates ne dokumentet e tenderit ishte percaktuar si me poshte: 2.11 Kohezigjatja e kontrates ose afati i zbatimit të kontrates: 12 muaj 2.11.1. Kohezigjatja e Marrëveshjes Kuadër: 12 muaj (dymbëdhjete) Kohezigjatia në muaj: 12 muaj (dymbëdhjete) Ne Shtojcën 6 Formulari i sasisë dhe grafikut te levrimit, eshte percaktuar si me poshte: Afatet e levrimit: 90 dite KSHA sqaron se, ashtu si eshte percaktuar ne pikën 2.11.1. te njoftimit te kontrates te publikuar ne SPE per këte procedure prokurimi, kohëzgjatja e marreveshjes kuader eshte 12 muaj dhe afati i levrimit eshte ai i percaktuar ne Shtojcën 6 Formulari i sasis dhe grafikut te levrimit prej 90 ditesh.

***KSHA sqaron se, ashtu si eshte percaktuar ne DT, kriteret e perzgjedhjes se fituesit jane sipas gemes B) oferta ekonomike me e favorshme bazuar ne mim te pikes 4.4 Kriteret e perzgjedhjes se fituesit te njoftimit te kontrates te publikuar ne SPE per kete procedure prokurimi. Paragrafi i nënvizuar, objekt ankimi nga operatori ekonomik GAMMA ShPK eshte pjesë perberëse e dokumenteve standarde te tenderit te miratuara me ndryshimet e fundit ne date 05.10.2022 nga APP.*

Per sa me sipër, pretendimet e OE nuk qendrojnë.

KPP vëren, se autoriteti kontraktor i ka marre në shqyrtim si pretendime, lidhur me fjalinë e fundit “Për sa më sipër pretendimet e OE nuk qëndrojnë”. Komisioni gjykon, se ndodhur në kërkesën për sqarim nga ana e operatorit ekonomik, referuar përmbajtjes së kthim - përgjigjes autoriteti kontraktor ka sqaruar për paqartësitë tij, lidhur me kërkesat për sqarim.

Komisioni sjell në vëmendje, se këto sqarime duhet të publikohen në sistemin e prokurimit elektronik, në përputhje me përcaktimet e nenit 75 të LPP-së.

III.3 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Gamma” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit, sa i përket pikës 2.3.5 e 2.3.6 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, duke kërkuar heqjen e këtyre kriterëve si kriterë jo në përputhje me objektin e prokurimit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”, seksionin II “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pikën 2.3.5 e 2.3.6, të dokumenteve standarde të tenderit, autoriteti kontraktor ka parashikuar:

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të disponojë 5 (pesë) mjete transporti në pronësi ose me qira:

- Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet leje qarkullimi, siguracion, akt kolaudim.
- Për mjetet e marra me qira duhet të paraqitet kontrata e qirasë, leje qarkullimi, siguracion, akt kolaudim.

Për sa më sipër operatori ekonomik të paraqesë një deklaratë përkatëse sipas formatit të mëposhtëm:

Nr.	Lloji i mjetit	Targa	Kapaciteti mbajtes	Statusi
1				Pronësi/qira/perdorim

Shënim:

Për mjetet me status perdorimi qira/hua perdorje te disponohet kontrata perkatëse mes qiradhenesit dhe qiramarrësit.

Mjetet e transportit qe do te deklarohet detyrimisht do ti paraqitet Autoritetit Kontraktor per te qene pjese e planit te zbatimit te kontrates.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për të realizuar shpërndarjen e mallrave objekt prokurimi, si dhe shërbimin e transportit duhet të ketë minimalisht të punësuar, si më poshtë:

Stafi	Nr.
Shofer	5
Punetorë të thjeshtë	10
Total	15

- Për punonjësit e punësuar shofer të paraqitet kontratë pune përkatëse si dhe leje drejtimi për secilin.
- Për punonjësit e punësuar punetorë të thjeshtë të paraqitet vetëm kontratë pune përkatëse.

Për sa më sipër operatori ekonomik të paraqesë deklaratë në lidhje me stafin që disponon sipas formatit të mëposhtëm:

Nr.	Emër Mbiemër	Profesioni	Data e fillimit të marrëdhënieve te punes
-----	--------------	------------	---

Shënim:

Në lidhje me kërkesën që OE të disponojë 5 (pesë) persona me profesionin shofer, OE paraqet në staf 5 (pesë) punonjës, që jo domosdoshmërisht janë të regjistruar në listëpagesat e shoqërisë si shoferë, por që disponojnë lejen e drejtimit të tipit B dhe mund të realizojnë me sukses shërbimin e transportit, brenda afateve të ekzekutimit të kontratës.

III.3.2. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;

- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndëkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.3.3. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.

III.3.4. Në nenin 77 pika 1 dhe pika 4 “Kërkesat për kualifikim” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

[...]

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e

duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

III.3.5. Neni 40, pika 3, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon se: *“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

III.3.6. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike, në përputhje dhe në përpjesëtim me volumin e kontratës të përcaktuar në dokumentet e tenderit. Për autoritetin kontraktor është tepër e rëndësishme që të sigurohet që mallrat objekt-prokurimi të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, janë në përputhje me kërkesat në dokumentet e tenderit.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në përcaktimin apo vendosjen e kriterëve specifike, që në thelb konsiderohen si kritere fituese, për shkak të rëndësisë që kanë, ligjvënësi i ka parashikuar kufizime autoriteteve kontraktore brenda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre. Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, urdhërojnë, se përcaktimi i këtyre kriterëve duhet të jetë: (i) *në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës* (ii) *Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.* Autoriteti kontraktues është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret për kualifikim, mjafton që ato të mos jenë diskriminuese e përjashtuese.

III.3.7. Referuar pretendimit të operatorit ekonomik ankimues të paraqitur në ankesë, për heqjen e kriterit 2.3.5 e 2.3.6, duke parashtruar:

Ju sjellim në vëmendjen e autoritetit kontraktor disa fakte në lidhje me këtë kriter: - Në procedurat e mëparshme të organizuara nga Ministria e Arsimit ndër vite, asnjëherë nuk ka qenë parashikuar një kriter i tillë kualifikimi; edhe pse sasi dhe fondi limit në vitin e kaluar ishin më të mëdha. - Tipi i kontratës është Mallra dhe jo shërbime ku të kërkohen automjete, shoferë dhe punonjës ngarkim-shkarkimi. - Objekti i prokurimit është blerje pajisje didaktike dhe jo transport pajisjesh didaktike që të kërkohen mjete transporti dhe fuqi punëtore. - Transporti i materialeve mund të kontraktohet nga fituesi me një kompani të specializuar transporti apo me një kompani postare dhe kjo mund të bëhet vetëm në rast të shpalljes fitues dhe jo më përpara. - Duke qenë se afati i lëvrimit është përcaktuar 90 (nëntëdhjetë) ditë/12 (dymbëdhjetë) muaj, atëherë logjika e përdorur në argumentimin e këtij kriteri nuk qëndron

pasi 1 (një) mjet mund ti kryejë të gjitha pjesët e atdheut sipas ndarjes që i ka bërë njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit. - Në kriteret e veçanta të kualifikimit është kërkuar: Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit, shpërndarjen dhe instalimin nëpër vende të të gjithë artikujve në adresat e përcaktuara në plan shpërndarje. Paraqitja e kësaj deklarate është e mjaftueshme për të bindur autoritetin kontraktor se operatori ekonomik do të marrë përsipër kryerjen e shërbimit të transportit, shpërndarjen dhe instalimin e produkteve objekt prokurimi. - Në fund të shtojcës 7 kriteret e kualifikimit autoriteti kontraktor ka përcaktuar, operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike financiare (nënpikat e seksionit 2.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike (nënpikat e seksionit 2.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Sa më sipër me logjiken e njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit një operator ekonomik për të marrë pjesë në të treja lotet duhet të ketë 15 mjete transporti, 15 shoferë dhe 30 punonjës së thjeshtë! Kaq shumë mjete dhe punonjës nuk kërkohen në prokurimet e punëve publike dhe përsëritim edhe njëherë që objekti i prokurimit nuk është transporti i nxënësve në shkolla por furnizimi i shkollave me mjete didaktike! Ligji nr. 162/2020 datë 23.12.2020 për prokurimin publikë i ndryshuar, përcakton se kriteret e kualifikimit duhet të jenë në përputhje me objektin e prokurimit dhe në rastin konkret ky kriter nuk është dhe si i tillë kërkohet që të hiqet. NË kriteret e veçanta të kualifikimit është kërkuar: 2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për të realizuar shpërndarjen e mallrave objekt prokurimi, si dhe shërbimin e transportit duhet të ketë minimalisht të punësuar, si më poshtë: Staf i Nr. Shofer 5 punëtorë të thjeshtë 10 Total 15 - për punonjësit e punësuar shofer të paraqitet kontratë pune përkatëse si dhe leje drejtimi për secilin. - për punonjësit e punësuar punëtorë të thjeshtë të paraqitet vetëm kontratë pune përkatëse. Për sa më sipër operatori ekonomik të paraqesë deklaratë në lidhje me stafin që disponon sipas formatit të mëposhtëm: Nr. Emër mbiemër Profesion Data e fillimit të marrëdhënieve të punës shënim: NË lidhje me kërkesën që OE të disponojë 5 (pesë) persona me profesionin shofer, OE paraqet në staf 5 (pesë) punonjës, që jo domosdoshmërisht janë të regjistruar në listëpagesat e shoqërisë si shoferë, por që disponojnë lejen e drejtimit të tipit B dhe mund të realizojnë me sukses shërbimin e transportit, brenda afateve të ekzekutimit të kontratës. Argumentimi: NË bazë të nenit 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publikë, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Gjithashtu për shkak se shtrirja e shkollave ku do dorezohen mallrat objekt prokurimi është në të gjithë territorin e RSH si dhe dorezimi i mallrave do të kryhet në kohe të njëjta, gjykojmë se nr i punonjesve i caktuar është minimal. Sjellim në vëmendjen e autoritetit kontraktor disa fakte në lidhje me këtë kriter: - NË procedurat e mëparshme të organizuara nga Ministria e Arsimit ndër vite, asnjëherë nuk ka qënë parashikuar një kriter i tillë kualifikimi; edhe pse sasi dhe fondi limit në vitin e kaluar ishin më të mëdha. - Tipi i kontratës është Mallra dhe jo shërbime ku të kërkohen shoferë dhe punonjës punonjës ngarkim-shkarkimi. - Objekti i prokurimit është blerje pajisje didaktike dhe jo transport pajisjesh didaktike. - Transporti i materialeve mund të kontraktohet nga fituesi me një kompani të specializuar transporti apo me një kompani postare dhe kjo mund të bëhet vetëm në rast të shpalljes fitues dhe jo më përpara. NË këto kushte kërkesa për shoferë dhe

punonjës të thjeshtë është e ekzagjeruar dhe nuk është në përputhje me objektin e prokurimit. - Duke qenë se afati i lëvrimit është përcaktuar 90 (nëntëdhjetë) ditë/12 (dymbëdhjetë) muaj, atëherë argumentimi i njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit se dorëzimi i mallrave do të kryhet në kohë të njëjtë nuk qëndron. Gjithashtu edhe propozimi i tyre që shoferët mund të kontraktohen pa qenë të siguruar në listëpagesa, nuk qëndron! - Në kriteret e veçanta të kualifikimit është kërkuar: Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit, shpërndarjen dhe instalimin nëpër vende të të gjithë artikujve në adresat e përcaktuara në plan shpërndarje. Paraqitja e kësaj deklaratë është e mjaftueshme për të bindur autoritetin kontraktor se operatori ekonomik do të marrë përsipër kryerjen e shërbimit të transportit, shpërndarjen dhe instalimin e produkteve objekt prokurimi. - NË fund të shtojcës 7 kriteret e kualifikimitë autoriteti kontraktor ka përcaktuar operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike financiare (nënpikat e seksionit 2.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike (nënpikat e seksionit 2.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Sa më sipër me logjikën e njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit një operator ekonomik për të marrë pjesë në të treja lotet duhet të ketë 15 mjete transporti, 15 shoferë dhe 30 punonjës së thjeshtë! Kaq shumë mjete dhe punonjës nuk kërkohen në prokurimet e punëve publike dhe përsëritim edhe njëherë që objekti i prokurimit nuk është transporti i nxënësve në shkolla por furnizimi i shkollave me mjete didaktike! Ligji nr. 162/2020 datë 23.12.2020 për prokurimin publikë i ndryshuar, përcakton se kriteret e kualifikimit duhet të jenë në përputhje me objektin e prokurimit dhe në rastin konkret ky kriter nuk është dhe si i tillë kërkojmë që të hiqet

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është me vend të ndalet në një test balancues të dy elementeve kryesore. Së pari, nëse kërkesa në fjalë për një numër prej 5 mjetesh transporti është e përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti, nëse kërkesa në fjalë shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. Gjithashtu, në shqyrtimin e kriterit të mësipërm të kualifikimit, KPP gjykon të ndalet edhe në faktin, nëse kriteri i mësipërm është në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet, në zbatim të nenit 77, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar. Në rastin konkret, referuar objektit të prokurimit, përmasave të kontratës, mallrave që do të lëvrohen si dhe afatit të lëvrimit, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në respekt të parimit të proporcionalitetit, duhet të ulë numrin e mjeteve të kërkuara, pasi kërkesa e autoritetit kontraktor për 5 mjete është e ekzagjeruar dhe ndikon në uljen e konkurrencës në radhët e operatorëve ekonomikë. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se synimi parësor i autoritetit kontraktor është vërtetimi se ofertuesi disponon mjetet e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoritetet kontraktore në hartimin e kriterëve dhe/ose specifikimeve teknike krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit duhet të kenë në vëmendje faktin se hartimi i tyre duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Sa më lart, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin e

mësipërm, duke ulur numrin e mjeteve me qëllim krijimin e një konkurrence gjithëpërfshirëse dhe jodiskriminuese.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për heqjen e kriterit 2.3.6, pasi nuk është në përputhje me objektin e prokurimit, KPP gjykon, se për të njëjtin arsyetim që është përdorur më sipër, autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin 2.3.6, duke ulur numrin e shoferëve dhe punëtorëve të thjeshtë me qëllim krijimin e një konkurrence gjithëpërfshirëse dhe jodiskriminuese.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë pjesërisht.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik për modifikimin e dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, sa i përket kriterit 2.3.7 të dokumenteve të tenderit duke kërkuar: [...] 2.3.7 për artikujt që kanë nevojë për tu trajnuar staf i pedagogjik, OE duhet të disponoj një trajnues me profesion kimist/ekuivalent, i cili duhet të jetë i trajnuar nga prodhuesi apo distributori i autorizuar. Shenim Per te vertetuar kriterin 2.3.7, OE pjesemarrëse mund te paraqese nje vertetim/certifikate nga prodhuesi apo distributori i autorizuar nga prodhuesi. Argumentimi: NË bazë të nenit 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publikëautoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. Gjithashtu duke pasur parasysh disa prej artikujve duhen montuar dhe duhet trajnuar staf i pedagogjik per menyren se si funksionon aparatura. Si p.sh. 7 art.4,5,7,8,9,10 etj. E kimise. NË lidhje me këtë kriter kualifikimi kërkojmë modifikimin e tij duke hequr kërkesën e trajnimit nga prodhuesi apo distributori i autorizuar për arsye se: - nuk ka nevojë për trajnim nga prodhuesi pasi aparaturat janë të shoqëruara me manual përdorimi dhe montimi si dhe vënia në punë e tyre është shumë e thjeshtë dhe nuk ka nevojë për trajnim të veçantë. - një gjë e tillë mund të bëhet me vetëdeklarim në ofertë që furnizuesi të garantojë vënien në punë dhe trajnimin e stafit për pajisjet që mund të ketë nevojë. - një rast që kufizon konkurrencën e lirë dhe të ndershme është rasti që në morinë e artikujve që prokurohen prodhuesit apo distributorët e autorizuar mund të jene të shumtë në numër dhe praktikisht është e pamundur një gjë e tillë përveç kostove shtesë artificiale..” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1.Në shtojcën 7 “Formulari i kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit”, Kapaciteti teknik, pika 2.3.7, autoriteti kontraktor ka parashikuar:

2.3.7 Për artikujt që kanë nevojë për t’u trajnuar staf i pedagogjik, OE duhet të disponojë një trajnues me profesion kimist/ekuivalent, i cili duhet të jetë i trajnuar nga prodhuesi apo distributori i autorizuar.

Shenim

Per te vertetuar kriterin 2.3.7, OE pjesemarrëse mund te paraqesi nje vertetim/certifikate nga prodhuesi apo distributori i autorizuar nga prodhuesi.

III.4.2. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit”, 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *“Qëllimi i këtij ligji është: a) të rrisë efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik”.*

III.4.3. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën”.*

III.4.4. Në nenin 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *“1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi”.*

III.4.5. Në nenin 77, pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: *“Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”.

4.Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.4.6. Neni 40, pika 3, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon se: *“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

III.4.7. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor harton dokumentet e tenderit, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Referuar testit të proporcionalitetit vendosja e kriterëve nga ana e autoritetit kontraktor duhet të jetë në proporcion me objektin e prokurimit dhe në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Duhet të ekzistojë një raport i arsyeshëm i kriterëve të vendosura dhe realizimit me sukses të kontratës. Komisioni sjell në vëmendje të autoritetit kontraktor faktin, se duke qenë se fryma e Ligjit të Prokurimit Publik bazohet në këto parime: “mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve; transparencë në procedurat e prokurimit; barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve”, kriteret për kualifikim duhet të hartohen në mënyre të tillë që të jenë gjithëpërfshirëse, si dhe të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël e të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik.

III.4.8. Lidhur me pretendimin e ankimuesit për heqjen e trajnuesit me profesion inxhinier kimist/ekuivalent, i cili duhet të jetë i trajnuar nga prodhuesi apo distributori i autorizuar vërtetuar kjo me vertetim/certifikate nga prodhuesi apo distributori i autorizuar nga prodhuesi, Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson se kërkesa e mësipërme, është një kërkesë e ekzagjeruar dhe në kundërshtim me parimet dhe rregullat e prokurimit publik. Operatori ekonomik me të drejtë kundërshton dhe këtë kërkesë të Autoritetit Kontraktor si të ekzagjeruar

dhe që duhet të hiqet, pasi nuk i shërben objektit të prokurimit. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor në përcaktimin e kërkesave për kualifikim duhet të ketë parasysh që ato t'i shërbejnë dhe të jenë në funksion të qëllimit të objektit të procedurës së prokurimit, duke lehtësuar punën e operatorëve ekonomikë në përgatitjen e ofertave të tyre. Në rastin konkret, kërkesa e autoritetit kontraktor për trajnues me profesion inxhinier fizike/ekuivalent, i cili duhet të jetë i trajnuar nga prodhuesi apo distributori i autorizuar vërtetuar kjo me vërtetim/certifikatë, është kërkesë e tepruar, sepse ashtu sikurse operatori ekonomik ankimues pretendon në ankesë, mallrat objekt - prokurimi janë të shoqëruara me manual përdorimi dhe montimi dhe vënia në punë e tyre është e thjeshtë dhe nuk ka nevojë për trajnim të veçantë Po ashtu, referuar objektit të prokurimit, AK prokuron blerje pajisje didaktike, dhe kërkesa për një trajnues me profesion inxhinier kimist/ekuivalent, i cili duhet të jetë i trajnuar nga prodhuesi, është një kërkesë e ekzagjeruar dhe nuk ka lidhje me objektin e prokurimit, prandaj autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për heqjen e saj.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen, për pjesën e pranuar të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Gamma” SHPK, në procedurën e prokurimit *E hapur, mbi kufirin e lartë monetar*, me objekt “*LOTI II: “Blerje pajisje didaktike për kimi, arsimit bazë dhe i mesëm”* me Nr. REF-06447-05-24-2024 me fond limit: 32,009,816.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 26-06-2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.
2. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Gamma” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse, për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Gamma” SHPK.

6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri

